

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Shoqeria "LURA" shpk.

NIPT-J61901122Q

Tirane

Shoqera "SPV LURA HOTEL" shpk

NIPT- M119145070

Tirane

Date 20/10/2021

MAREVESHJE PER TRANSFIRIM E VEPRIMTARISE EKONOMIKE DHE TE KALIMIT TE ASETETEVE NGA SUBJEKTI "LURA" shpk TEK SUBJEKTI "SPV LURA HOTEL" shpk.

Une Dod DOÇI ,Administratori i Shoqerise "LURA" shpk me NIPT- J61901122Q me qender ne TIRANE Rruga Mustafa Matohiti, Pallati Abao, Shk nr.1, Kati 2.

, me me objekt veprimtarie te regjistruar ne QKB ;

Punime kat.1 punime dheu,murature,beteon,Kat.2 ndertime civile,industriale turistike,bujqesore,kat.3 punime restaurimi,kat.4 vepra ,kat.9 /a,b,c,kat I diga ,galeri e tunele.Tregtim i artikujve te ndryshem ushqimore e industriale me shumice e pakice,import dhe eksport,agjensi per shitblerje dhe dhenie me qira te pasurive te tundshme dhe te patundshme,agjensi komisionere.Tregtim ne bar bufe restorant.Objekt ne fushen e telekomunikacionit dhe te energjitikes. Bujqesise, akuakultures, peshkimit, peshkimit ne det, peshkimit ne laguna, peshkimit ne ujerat e embla, rritja e peshkut, midhjeve, etj, gjuetise, blektorise,

pemetarise. Administrimit te pyjeve dhe kullotave.

Mbareshtimit te flores dhe faunes se eger. Veprimtari turistike pushimi dhe argetimi. Ne fushen e Mjedisit. Hapje institucioni jopublik te arsimit te larte, Botime, shtypje librash, revistash dhe materialesh te tjera per arsimin e larte

dhe tregetimii tyre.Strukture Akomoduse.



Une Esmeralda DOÇI, Administratori i shoqërisë "SPV LURA HOTEL" shpk , me NIPT-M119145070 me qendë , Durres Ishem LALEZ Kompleksi Lura 2, Hotel.

Me object veprimtarie ;

Aktivitet në fushën e turizmit, hapja dhe menaxhimi i hoteleve, e godinave dhe ambienteve në të cilat ushtrohet aktiviteti hotelier. Hapja dhe menaxhimi i sallave të konferencave në kuadër të aktivitetit hotelier. Hapja, menaxhimi dhe funksionimi i qendrave të rekreacionit, me ose pa profil të dermo-estetikës, trajtimit të lekures dhe trupit, për masazhe, spa, mirëmbajtje trupore, fitness, dhe

pishina. Aktivitet në fushën e qiradhenies së zyrave, ambienteve tregtare dhe/ose pasurive të tjera të paluajtshme që perkasin hotelit. Kryerja e tregtimit, prodhimit dhe përpunimit të mallrave, që kanë të bëjnë me aktivitetin e

hotelerisë. Hapja e menaxhimi i bareve dhe restoranteve brenda strukturës hoteliere si edhe ushtrimi i aktivitetit në fushën e këmbimit valutë dhe të mallrave të cmuar, bizhuteri, apo sende me vlerë të kuotuarë në bursë. Hapja

dhe mbajtja e aktiviteteve të lojrave të fatit e kazinove, brenda strukturave hoteliere dhe çdo gjë tjetër që përfshijnë fushat e mesipërme, të lejuara nga ligji.

Plazh Privat. Kryerja e operacioneve ekonomike e juridike, industriale, prodhuese, tregtare që lidhen drejtperdrejt ose terthorazi me objektin e veprimtarisë së shoqërisë, brenda kuadrit të dispozitave ligjore për

realizimin e çdo biznesi të përshtatshëm në arritjen e qëllimit të shoqërisë.

Mbeshtetur në Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligjin nr.92/2014 dt.27.04.2014 "Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", Udhezimin nr.6 datë 30.01.2015 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", si dhe Vendimin e ortakut të shoqërisë "LURA" shpk që do të transferojë aktivitetin e veprimtarisë së Hotelierë Turizem që i përket , Durres Ishem LALEZ Kompleksi Lura 2, Hotel. Me object veprimtarie ;

Hotel , shërbimeve të bar restorant dhe të tjera që lidhen me to.



SPV LURA HOTEL , do te pranoje aktivitetin , si dhe aktivet (asetet) qe i perkasin keti aktiviteti.

Sa me lart , bejne kete mareveshje ;

Shoqeria "LURA "shpk do te transferoje asetet (aktive afat Gjata) qe perdoren ne funksion te ketij aktiviteti ;

Asetet qe do te transferohen nga "LURA"shpk J61901122Q tek "SPV LURA HOTEL" shpk , me NIPT- M119145070 jane ;

1.TOKE TRUALL = 286,689,488

2.AQUA RESTORANT = 22,969,759

3.HOTELI = 543,432,283.

4.MJETE TRANSPORTI= 1,516,675

5.MAKINERI DHE PAISJE = 11,092,330

6.MOBILJE DHE PAISJE = 82,849,722

7.PAISJE KOMPJUTERIKE= 2,196,219

Totali i vleres se AAM qe do te transferohen ; 950,746,476 leke.

Aktivitet sipas klasifikimit kontabel te mesiperme , jane te vleresuara me kosto historike

.

Shoqeria pritesse e transferimit do te mbaje te punesuar te gjithë punonjesit qe i perkasin keti aktiviteti me kushte qe kishin .

Vlera e aseteve(AAM) qe do te transferohen do te behet me vleren qe eshte ne kontabilitetin e shoqerise LURA shpk ne momentin e transferimit , taransferimi do te behet me fature te rregullt tatimore pa tvsh.



Transferimi do te dokumentohet dhe me faturen e shitjes perkatese me , nr. ser. Te rregullt tatimore ,Qe subjekti "LURA"shpk do te leshoje per subjektin "SPV LURA HOTEL "" shpk, Vlera ne Fature eshte pa tvsh mbeshtetur ne Legjisacionin e lart permendur. Meqenese eshte transferim aktiviteti nga aktivitete me tvsh ne subjekt me aktivitet me tvsh.

Referuar ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, transferimi tërësor apo i pjesshëm i veprimtarisë ekonomike nuk përbën furnizim malli ose furnizim shërbimi dhe për pasojë nuk është i tatueshëm për TVSH-në. Pjesa apo tërësia e veprimtarisë ekonomike e cila transferohet mund të vazhdojë një aktivitet ekonomik të pavarur, në kushte të ngjashme si përpara transferimit.

Procedura e transferimit të veprimtarisë dhe rregullat që duhet të zbatohen:

- 1) Transferimi i veprimtarisë bazohet mbi një kontratë (akt transferimi) të noterizuar midis transferuesit dhe marrësit të transferimit i cili regjistrohet në pasqyrat financiare të ndërmarrjes;
- 2) Të gjitha të dhënat, librat dhe regjistrimet që kanë të bëjnë me tërësinë e asetëve apo pjesën e tyre që është transferuar, të detyrueshme për t'u mbajtur, pas transferimit, në vend të transferuesit duhet të mbahen nga marrësi i transferimit.
- 3) Transferimi të bëhet ndërmjet dy personave të tatueshëm të regjistruar për TVSH-në.
- 4) Për aktivet e luajtshme që transferohen, afati i rregullimit në përputhje me ligjin, fillon nga data e blerjes ose prodhimit të aktivitet nga personi i tatueshëm transferues.
- 5) Rregullime të TVSH-së së zbritshme, bazuar në parimin dhe të drejtën e zbritjes, sipas rastit do të bëhen përkatësisht kur kemi të bëjmë me ndryshime të veprimtarisë nga veprimtari e tatueshme në të përjashtuar nga TVSH-ja.
- 6) Palët e përfshira në transferim, në aktin e transferimit, duhet të shprehen dhe të evidentojnë TVSH-në e zbritshme dhe të drejtën e kalimit të saj ose jo, tek marrësi i transferimit.
- 7) Autoriteti tatimor bën vetërregullimin e TVSH-së nëse transferuesi nuk e ka kryer atë dhe personi i tatueshëm marrës i transferimit nuk gëzon të drejtën të njohë si të zbritshme këtë TVSH.
- 8) Në çdo rast akti i transferimit (kontratë e noterizuar) shoqërohet detyrimisht me një kartelë ku evidentohet çdo aktiv i trupëzuar (i luajtshëm dhe i paluajtshëm), vlera e tatueshme dhe TVSH-ja e zbritshme në momentin e blerjes ose prodhimit të aktivitet të vërtetuar me dokumentacionin përkatës të blerjes së aktivitet dhe data e blerjes së tij.

9) Transferuesi e dokumenton me faturë tatimore shitje transferimin e tërësisë së aseteve ose tërësisë së pjesshme ku evidentohen zërat përkatës të bilancit që transferohet dhe vlera totale e transferimit. Nëse transferuesi lëshon një faturë që përfshin TVSH-në, ai është përgjegjës për TVSH-në e faturuar. Në raste të tilla, marrësi i transferimit nuk gëzon të drejtën të zbrësë TVSH-në.

10) Transferuesi dhe marrësi i transferimit detyrohen që të njoftojnë autoritetin tatimor kur kryejnë transferim të veprimtarisë ekonomike, të paktën 45 ditë kalendarike përpara se të ndodhë transferimi.

Shoqerite pjesmarse ne kete operacion ekonomik si dhenesi dhe maresi do te zbatoje te gjitha procedurat ligjore te transferimit;

Ne perfundim te ketij procesi krahas fatures do te behet kontrata perfundimtare e transferimit te aseteve nga shoqeria "LURA" shpk te shoqeria "SPV LURA HOTEL" shpk

kontrata do te behet nga administratoret e te dy shoqerive ne prezence te noterit dhe do te vleresohet nese do te paguhen aktivet nga "SPV LURA HOTEL" shpk per "LURA" shpk , apo do te behet si kapital i nenshkruar ,ku pronar eshte "LURA" shpk.

Administratori i shoqerise

"LURA" shpk.

Dod DOÇI



Administratori i shoqerise

"SPV LURA HOTEL" shpk

Esmeralda DOÇI

